



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova- Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), shpall këtë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: **Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm,**

Kategoria dhe grada e vendit të punës: **Nivel drejtues, koeficienti 19.35**

Nr. i ref : **AKSP-1/2012**

Raporton te: **Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së,**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Menaxhon dhe mbikëqyr personelin dhe veprimtarin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në AKSP,
2. Shfrytëzon burimet e Njësisë për Auditim të Brendshëm në mënyrë produktive kosto- efektive dhe efikase,
3. Siguron zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregullave, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve të përcaktuar me Ligjin për Auditim të Brendshëm,
4. Siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të planit strategjik të auditimit në bazë të vlerësimit të rrezikut për rishikim dhe miratim tek menaxhmenti i lartë i AKSP-së dhe Komiteti i auditimit,

5. Organizon, kryerjen, mbikëqyrjen dhe ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm të ndërmarrja nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, si dhe dorëzimin e rezultateve të auditimit të menaxhmenti i lartë i AKSP-së dhe Komiteti i auditimit të organizatës buxhetore ose ndërmarrjes publike,
6. Përgatit dhe dorëzon raporte tremujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm tek menaxhmenti i lartë i AKSP-së, NJQH dhe Komiteti i Auditimit të organizatës buxhetor,
7. Dorëzon planin vjetor dhe strategjik të Auditimit të brendshëm tek NJQH jo më vonë se deri më 31 Tetor të secilit vit kalendarik pas miratimit nga menaxhmenti i lartë i AKSP-së dhe Komiteti i Auditimit,
8. Mirëmban të gjitha dosjevet e raporteve të auditimit, shënimet gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet, dëshmitë që kanë të bëjnë me ato raporte dhe të gjitha rekomandimet e dhëna menaxhmentit të lartë të AKSP-së dhe Komitetit të auditimit të cilat duhet të ruhen së paku 7 (shtatë) vjet,
9. Përgatit dhe zbaton programin e sigurisë së cilësisë që mbulon vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të funksionit të auditimit të brendshëm,
10. Raporton menjëherë tek menaxhmenti i lartë i AKSP-së, dhe komiteti i auditimit, për çdo indikator të aktivitetit të mashtimit apo korrupsionit dhe jep propozime për përmirësimin e sistemeve si dhe njofton autoritetin kompetent nëse menaxhmenti i lartë i AKSP-së nuk ndërmerr veprime të duhura,
11. Kërkon burime të mjaftueshme nga menaxhmenti i lartë i AKSP-së për t'i mundësuar funksionit të auditimit të brendshëm kryerjen e detyrave të përcaktuara sipas Ligjit të Auditimit të Brendshëm,
12. Përgatit një plan për të Siguruar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të gjithë anëtarëve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, përfshirë edhe Drejtorin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm,
13. I dorëzon menaxhmentit të lartë të AKSP-së dhe Komitetit të auditimit, statutin mbi funksionin e auditimit të brendshëm, të bazuar në modelin e siguruar nga NJQHAB.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plote për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohet për pozitën përkatëse,

Procedura e konkurimit

Për pozitën e Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatet e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Shkollimi i kërkuar

- Diplomë universitare në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo juridik,
- Te jetë i certifikuar nga një organizatë e auditimit që është e njohur ndërkombëtarisht për auditim/kontabilitet apo trajnim i nevojshëm lidhur me menaxhim dhe auditim,

Aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri të mira të punës me kompjuter, me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point), fleksibiliteti dhe aftësia për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi të larta organizative dhe komunikuese, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vetiniciativa dhe përkushtimi i vëmendjes ndaj detaleve, aftësia për të punuar në një ambient ekipor, se paku pesë (5) vjet përvojë pune, dy prej tyre në fushën përkatëse (e nevojshme), dhe njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Përzgjedhja e Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm behet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Rregulloren Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil, si dhe Ligjin Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm.

Kohëzgjatja e emërimit

Për pozitën e Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, emërimi është me kohe të pacaktuar (karrierës), periudha provuese 12 muaj.

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 18.01.2012 deri me datën 01.02.2012.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Zyra e Personelit, dhoma nr.1. kati I, ndërtesa e re administrative Vushtrri, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: www.aksp-gov.net Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera te nevojshme që kërkohet për vendin e punes për të cilin konkurren.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Për informata me te hollësishme mund te kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 570 008 Ext 114 ose 233, prej orës 08:00 - 1600.